


Gjeobombardimi është një teknikë që mund të shfrytëzohet për të mundësuar shpërndarje më efektive të video fushatave tuaja nga YouTube nëpërmjet aplikacioneve për harta të Google siç janë Google Maps dhe Google Earth. Tani ju mund t'i shihni videot tuaja me etiketë gjeografike brenda në Google Earth dhe Google Maps. Çdo video YouTube me etiketë gjeografike do të paraqitet kur shtesa për Youtube në Google Earth/Maps është e aktivizuar.

**✓ P**ërdorimi i suksesshëm i teknikës së gjeobombardimit

Kjo teknikë është shfrytëzuar nga do ta shihni atë të mbuluar me video të aktivistët tunizianë nga blogu kolektiv njëjta për liritë qytetare, që Ben Aliu [Nawaat.org](#) (Bërthama) për t'i lidhur përpiquej t'i pengonte qytetarët tunizianë dhjetëra video dëshmi të të burgosurve që përdorin Internetin t'i shihnin ato, politikë tunizianë dhe mbrojtësve të të duke i bllokuar dy web-faqet e drejtave të njeriut, me lokacionin e famshme për ndarje të videove, pallatit presidencial të Tunisit në Google Youtube dhe DailyMotion. Earth. Tani, kur fluturoni mbi pallatin presidencial të Tunisit në Google Earth

**📍 Etiketimi gjeografik i videove tuaja paraqet një mënyrë të shkëlqyer për t'i ndarë përshtypjet tuaja me shikuesit tuaj.**



 Shikojeni protestën virtuale në Pallatin Presidencial të Tunisit në Google Earth: Mund ta [shkarkoni](#) këtë fajll kmz (Keyhole Markup Zip) të Google Earth, që do ta startojë Google Earth-in (duhet ta keni të instaluar më parë) dhe do t'ju shëtisë nëpër Pallatin Presidencial të Kartagenës.

**“V**lerësime

Aktivistët tunizianë dhe përkrahësit e tyre organizuan një “protest digjitale”, duke i lidhur një duzinë videosh për liritë qytetare me fotografinë e pallatit presidencial në Google Earth. Në këtë mënyrë, një tregim me përmasa të vogla për të drejtat e njeriut u shndërrua në fushatë elegante globale. [The Economist](#).

Është për t'u çuditur se sa pak bombardim ka pasur deri tani me Google Earth, duke pasur parasysh reputacionin e lartë të këtij aplikacioni (...) Është koha për t'i definuar termet “Gjeobombardim me Google” ose “bombardim me Google Earth”, atëherë (...) Edhe sikur definicioni të jetë jo shumë i qartë, nuk ka dyshim se gjeobombardimi me Google është një mundësi e shkëlqyer dhe e lirë për reklamim gueril. [Ogle Earth](#)

# Si ta bëj?

## 1- Vënia etiketë gjeografike videos suaj

Gjatë procesit të vendosjes së videos tuaj në YouTube, asaj mund t'i veni etiketë gjeografike duke ia bashkangjitur një lokacion.

Mund t'i shtoni lokacion gjeografik cilësdo video tuaj YouTube, qoftë e re apo e vjetër:

- ★ Redaktoni (edit) videon tuaj;
- ★ Klikoni në opcionin "date and map" ("data dhe harta");
- ★ Shtoni gjerësinë dhe gjatësinë gjeografike ose shkruani një qytet, vend ose emër vendbanimi;
- ★ Mund ta shfrytëzoni kutinë për kërkim ose ta zvarritni treguesin për të zgjedhur lokacion specifik.

Date and Map Options: No date or location has been set [choose options](#)

Click the "Date and Map Options" to display the maplet

Date and Map Options:

Date Recorded:    Today Clear

Map Video:  Search Clear

Map Satellite Hybrid


Search for the place where you recorded your video. Drag the marker to choose a specific location.

drag the marker or use the search browser to choose a specific location

Pasi që të jetë regjistruar lokacioni dhe të jetë vendosur videoja, ajo do të paraqitet në Google Earth.

## 2- Si t'i paraqesim videot YouTube me etiketë gjeografike në Google Earth?

Për ta aktivizuar shtresën Google YouTube, duhet të shkoni në menynë “Layers” (“Shtresat”) në anën e majtë të Google Earth. Pasi ta zgjeroni nyjen “Gallery” (“Galeria”) në listën e shtresave do të paraqitet shtresa “Youtube”. Pasi të klikoni në kutinë afër shtresës Youtube, të gjitha ikonat e Google YouTube do të paraqiten anëmbanë globit.



**METAMORPHOSIS**  
Foundation for sustainable ICT solutions

Përkthyer nga:  
Metamorphosis Foundation  
[www.metamorphosis.mk](http://www.metamorphosis.mk)



**2.0** Guide  
Tools for Digital Advocacy